



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Dy dëshmitarë dhanë dëshmi këtë javë në çështjen gjyqësore për krime lufte të *Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit* dhe *Jakup Krasniqit*. Të hënën, 10 shkurt, Prokuroria thirri një dëshmitar që dha dëshmi nëpërmjet videolidhjes dhe kryesisht në seancë private. Sipas përmbledhjes që u lexua në sallë të gjyqit, dëshmitari dhe afërmi i tij u rrëmbyen në qershor 1999 nga burra të armatosur të veshur me uniformë të UÇK-së dhe u çuan në një vend ndalimi, ku u morën në pyetje dhe keqtrajtuat.

Ky dëshmitar përfundoi dëshminë të hënën dhe pas tij filloi Sylejman Selimi. Zotit Selimi iu caktua një mbrojtës gjatë dëshmisë, për t'i dhënë mundësinë të kërkonte udhëzime për aspekte të vetinkriminimit të mundshëm. Dëshmia e z. Selimi vazhdoi gjatë gjithë javës.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 7 shkurt, Trupi Gjykues vendosi se deklaratat me shkrim të dy dëshmitarëve dhe një provë materiale shoqëruese mund të pranoheshin si prova, duke theksuar se dëshmitë me shkrim nuk e dëmtonin padrejtësisht Mbrojtjen, sepse Mbrojtja do të ketë mundësinë të marrë në pyetje dëshmitarët për të gjitha aspektet që gjykohen relevante. Gjithashtu, Trupi Gjykues hodhi poshtë kërkesën e Prokurorisë për pranim të një prove materiale sipas rregullës 154 dhe miratoi një kërkesë tjetër për t'i shtuar listës së provave materiale disa dokumente, duke theksuar se Mbrojtja nuk e kundërshtoi këtë.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për të martën, 18 shkurt, duke filluar në orën 9 paradite.

Në çështjen gjyqësore tjetër të *Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit* për ndikim të pretenduar ndaj dëshmitarëve, më 6 shkurt, Administratorja njoftoi Gjykatësen e Procedurës Paraprake se znj. Nina Tavakoli ka kërkuar miratimin e Administratores për të ndërprerë përfaqësimin e z. Thaçi prej saj në këtë çështje gjyqësore. Më pas, më 10 shkurt, Administratorja njoftoi për kërkesën e bashkëmbrojtëses aktuale të z. Thaçi, z. Sofi Menegon, për të zëvendësuar z. Tavakoli si kryembrojtëse.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 7 shkurt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi vendime më vete mbi vazhdimin e paraburgimit të Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hashim Thaçit. Në të tre vendimet, Gjykatësja konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku që të akuzuarit të arratisen, pengojnë ecurinë e procesit dhe/ose të kryejnë vepra penale të tjera.

Versioni i redaktuar publik i vendimit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake që konfirmon Aktakuzën në këtë çështje gjyqësore ka dalë dje dhe mund ta gjeni në faqen e internetit të DHSK-së. Vendimi origjinal për konfirmimin e aktakuzës u lëshua më 29 nëntor 2024.

1





Në vendim jepen hollësi të mëtejshme për materialet e dorëzuara nga Prokuroria në mbështetje të aktakuzës, përfshirë në lidhje me një numër vizitash në objektin e paraburgimit, gjatë të cilave pretendohet se z. Thaçi u dha vizitorëve udhëzime për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve në gjykimin aktual të tij për krime lufte, si dhe hollësi për transkriptet që lidhen me këto vizita.

Ndër të tjera, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se materiali mbështetës tregon se z. Thaçi "i ngarkoi secilit grup detyrën për të kontaktuar dëshmitarë të ndryshëm të ZPS-së, disa prej të cilëve z. Thaçi i cilësoi në mënyrë specifike si "vendimtarë" [...] zbuloi në mënyrë të përsëritur dhe të qëllimshme, pa autorizim, informacion të mbrojtur ..." dhe "inkurajoi dhe nxiti në mënyrë të qartë, në kontekstin e secilit grup, d.m.th. të grupit Fazliu, grupit Smakaj dhe grupit Kilaj, zotërinjtë Fazliu, Smakaj dhe Kilaj, që të merrnin dhe mbanin mend udhëzimet e sakta të tij dhe të kontaktonin dëshmitarët e shënjestruar, me synim ndikimin në mënyrë të paligjshme në dëshmitë e ardhsme (në atë kohë) të tyre në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët*."

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, Paneli i Gjykatës së Apelit miratoi kërkesën e Mbrojtjes për zgjatje të afatit për dorëzim të dosjes së apelit kundër Urdhrit për Zhdëmtim. Mbrojtja ka afat tani të dorëzojë dosjen deri më 14 mars 2025.

